

## ABSTRAKTI

### “Mbrotjtja e fëmijëve dhe ligjet që rregullojnë autoritetin e shtetit për të ndërhyrë”

Rruga e drejtësisë për mbrojtjen e fëmijëve është një proces që ka kaluar në etapa të ndryshme historike, duke u përpjekur që të garantohen dhe të promovohen të drejtat dhe interesat e fëmijëve në shoqëri. Konventat ndërkombëtare, kryesisht Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e miratuar në nivel global, kanë luajtur një rol kyç në këtë proces me vendosjen masave të nevojshme për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe për të siguruar që ato të respektohen nga shtetet dhe shoqërit e tyre.

Në të kaluarën në Kosovë ishin të drejtat zakonore mbarëshqiptare e në veçanti kanunet si norma dominuese të rrënjosura ndërmjet anëtarëve të një kolektivi apo bashkësive të caktuar. Me zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore, fillojë vetëdijesimi i shoqërisë, rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe kapaciteteve në krijimin e bazave ligjore të vlerësuara si humane dhe të drejta në përcaktimin e kufijve të veprimtarisë së shtetit. Mungesa e një legjislacioni adekuat mund të çojë në uljen e efikasitetit të organeve kompetente dhe ngritjen e pasojave negative.

Sistemi juridik i Republikës së Kosovës ka ngritur përgjegjshmërinë e mekanizmave institucional kushtuar sigurisë juridike përpara popullit e në veçanti fëmijëve. Fokusi kryesor i këtij studimi janë të drejtat e fëmijëve dhe sqarimi i dilemave se me cilat ligje mund të mbrohen fëmijët në rastet kur bien ndesh me ndonjë padrejtësi. Ligjet të cilët autorizojnë shtetin për të ndërhyrë në rastet kur të drejtat e tyre janë kufizuar ose shkelur, i kërkojnë institucioneve të mbikëqyrin situatën e fëmijëve në rrezik dhe të ndërhyjnë në mënyrë efektive për t'i adresuar këto sfida. Duke analizuar këto sfida është e nevojshme që shteti dhe institucionet e tij të ndërmarrin masa të nevojshme kualitative për të forcuar ligjet dhe politikat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Studimi synon të pasqyroj punën e organizatave dhe mekanizmave institucional në nivel lokal dhe qendror, të profesionistëve dhe ekspertëve që punojnë për fëmijët, për parandalimin dhe trajtimin e formave të abuzimit dhe dhunës ndaj fëmijëve me theks të veçantë në Kosovë.

**Fjalë kyçe:** *Mbrojtja e fëmijëve, mekanizmat institucional, siguria, legjislacioni shtetëror, masat për mbrojtjen e fëmijëve, format e abuzimit dhe dhunës.*

**Mentori:** Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri

**Kandidatja:** Anduena Alshiqi